



Procedurat, dokumentacioni dhe masa e përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe për të larguarit nga puna si pasojë e Covid-19

Në Fletoren Zyrtare nr. 67 është publikuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 305, datë 16.04.2020 i cili përcakton procedurat, dokumentacionin dhe masën e përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe të larguarit nga puna si pasojë e Covid-19, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, e ashtuquajtura "Paketa Financiare nr. 2".

Në bazë të aktit të mësipërm ligjor, parashikohet dhënia e ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe të larguarit nga puna, si më poshtë:

- **Përfitues të ndihmës financiare në masën 40,000 lekë**, e cila mbulon periudhën prill-qershor dhe është e pagueshme vetëm një herë si një shumë e vetme, janë:
 1. Të punësuarit në subjekte me të ardhura vjetore mbi 14 milionë lekë, që kanë mbyllur aktivitetin si pasojë e urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 2. Ish të punësuarit në subjekte që janë lejuar të kryejnë aktivitet, të cilët janë larguar nga puna ndërmjet periudhës nga hyrja në fuqi e urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e deri më 10.04.2020 dhe janë deklaruar si të larguar përmes dorëzimit të formularit E-SIG-27/a brenda datës 10.04.2020;
 3. Të punësuarit në subjekte që ushtrojnë aktivitet si struktura akomoduese;
 4. Të punësuarit në subjekte me të ardhura vjetore deri në 14 milionë lekë, që janë lejuar të kryejnë aktivitet, të cilët kanë qënë në punë në datën e hyrjes në fuqi të urdhrave të mësipërm, me përjashtim të:
 - a. Individëve që përfitojnë ndihmë financiare si të ish punësuar, sipas pikës 2) të listës së përfituesve më lart;
 - b. Të punësuarve në subjektet e mëposhtme që janë lejuar të kryejnë aktivitet:
 - i. Tregtim produkte ushqimore, fruta-perime dhe farmaci; si dhe
 - ii. Avokat, noter, mjek i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, auditues ligjor, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë

Kusht i përbashkët për të gjithë përfituesit e listuar më lart është që të kenë qënë të punësuar e të figurojnë në listëpagesat e subjekteve përkatëse të paktën deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.



● **Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës financiare sipas këtij Vendimi:**

1. Individët e punësuar, të cilët kanë realizuar për vitin 2019 të ardhura bruto nga paga mbi 2 milionë lekë;
2. Individët e dypunësuar, nëse të paktën njëri nga aktivitetet ku individi është i punësuar gjendet i listuar në pikën 4).b).ii. më lart;
3. Të punësuarit në biznese me të ardhura vjetore deri në 14 milionë lekë, që kanë mbyllur aktivitetin si pasojë e urdhrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët përfitojnë ndihmë financiare në masën 26,000 lekë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.254, datë 27.3.2020 (pjesë e të ashtuquajturës Paketa Financiare nr. 1 – lutemi referojuni Njoftimit tonë nr.28);
4. Punonjësit e institucioneve shtetërore si dhe të punësuarit në shoqëritë me kapital shtetëror;
5. Punonjësit e organizatave jofitimprurëse.

● **Procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës financiare**

Subjektet që përmbushin kushtet e mësipërme paraqesin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet portalit e-filing formularin "Kërkesë për përfitim të ndihmës financiare 2", me të dhënat e përfituesve:

- i. Të dhënat e subjektit tatimpagues;
- ii. Të dhënat identifikuese të përfituesve;
- iii. Bankën dhe numrin e llogarisë bankare të përfituesve.

Brenda 10 ditëve pune, këto të dhëna verifikohen nga Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse nëpërmjet analizës së riskut dhe të dhënave disponibël për secilin tatimpagues në sistemin e-tax.

Ky vendim hyn në fuqi duke filluar nga data 18.04.2020 dhe i shtrin efektet gjatë gjendjes së epidemisë nga COVID-19, por jo më shumë se 3 muaj.



Procedures, documentation and amount of financial assistance for current employees and for dismissed employees due to Covid-19

In the Official Gazette no. 67 the Decision of the Council of Ministers no. 305, dated 16.04.2020 is published, providing the procedures, documentation and amount of financial assistance for current employees and for terminated employees due to Covid-19, during the period of the state of natural disaster, also known as "Fiscal Package no. 2".

On the above legal act, it is foreseen provision of financial assistance for current employees and dismissed employees, as follows:

- **Beneficiaries of the financial assistance amounting to ALL 40,000**, that covers the period April-June and is payable only once as a single amount, are:
 1. Employees in entities with annual turnover over ALL 14 million, that have closed the activity as a result of the orders of the Minister for Health and Social Protection;
 2. Former employees in entities who have been permitted to carry forward their activity, who have been dismissed during the period from the entry into force of the orders of the Minister for Health and Social Protection until 10.04.2020 and have been declared as dismissed through the submission of the E-sig-27/a within 10.04.2020;
 3. Employees in entities that carry forward their activity as accommodation facilities;
 4. Employees in entities with annual turnover up to ALL 14 million, that have been permitted to carry forward their economic activity and have been working in the date of entrance into force of the abovementioned orders, except for:
 - a. Individuals that benefit the financial assistance as former employees, based on point 2) of the list of beneficiaries above;
 - b. Employees of the following entities that are permitted to carry forward their activity:
 - i. Trade of food products, fruits and vegetables as well as pharmacy; as well as
 - ii. Advocate, notary, specialist physician, pharmacist, nurse, veterinarian, architect, engineer, physician-laboratory technician, designer, economist, agronomist, registered accounting expert, certified accountant and property appraiser

A common criteria for all the beneficiaries listed above is to have been employed and to be listed on the payrolls of the respective entities at least until the date of entry into force of the orders of the Ministry of Health and Social Protection.



- **Are exempt from benefiting the financial assistance based on this Decision:**

1. Employed individuals, who during 2019 have generated gross income from salary over ALL 2 million;
2. Individuals that are employed in more than one entity, if at least one of the activities where the individual is employed is listed in point 4).b).ii. above;
3. Employees in businesses with annual turnover up to ALL 14 million, that have closed their activity due to the orders of the Ministry of Health and Social Protection, that benefit financial assistance to the amount of ALL 26,000 based on the Decision of the Council of Ministers no.254, dated 27.3.2020 (part of the also known as Fiscal Package no. 1 – please refer to our Notification no. 28);
4. Employees of state institutions as well as employees in entities with state capital;
5. Employees of non-for-profit organizations.

- **Procedure and documentation for benefitting the financial assistance**

Entities that meet the abovementioned criteria must submit to the General Tax Directorate through the e-filing portal the form "*Request for benefit of financial assistance 2*", with the data of the beneficiaries:

- i. Data of taxpayer entity;
- ii. Identifying data of the beneficiaries;
- iii. Bank and bank account number of the beneficiaries.

Within 10 working days, these data are verified by the relevant Regional Tax Directorates through the risk analysis and based on the data available for each taxpayer in the e-tax system.

This decision enters into force starting from 18.04.2020 and extends its effects during the pandemic situation from COVID-19, but for no longer than 3 months.